

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin për të mitur e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka kryetare, Nesrin Lushta e Nebojša Bpričić, -anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të miturit Z. B. nga Prizreni, për shkak të veprave penale vjedhje nga neni 325.par.1.lidhur me nenin 31.të KPK, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK, vjedhje e rënd nga neni 327.par.1.pika 1.1.lidhur me nenin 28.dhe 31.të KPK dhe marrja në posedim e pasurisë së luajtshme nga neni 331.par.1.lidhur me nenin 31.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të miturit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren PM.nr.81/2013 të datës 04.03.2016. dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.36/2016 të datës 13.06.2016., në seancën e mbajtur më 12.10.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të miturit Z. B. anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren PM.nr.81/2013 i datës 04.03.2016. dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.36/2016 i datës 13.06.2016. në pjesën që ka të bëjë me të miturin Z. B. dhe në këtë pjesë lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren PM.nr.81/2013 të datës 04.03.2016. të miturit Z. B. i është shqiptuar masa edukuese dërgimi në institucionin edukativo korrektues në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh për veprat penale vjedhje nga neni 325.par.1.lidhur me nenin 31.të KPK, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK, vjedhje e rënd nga neni 327.par.1.pika 1.1.lidhur me nenin 28.dhe 31.të KPK dhe marrja në posedim e pasurisë së luajtshme nga neni 331.par.1.lidhur me nenin 31.të KPK. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale bijnë në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës ka marrë aktvendimin PAM.nr.36/2016 i datës 13.06.2016. me të cilin ankesat e paraqitura janë refuzuar si të pabazuara dhe aktvendimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturit, avokati V. O. nga Prizreni, nga përmbajtja e së cilës del se është ushtruar vetëm për pjesën që ka të bëjë me veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të anulohen në tërësi dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.174/16 të datës 13.09.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK dhe lidhur me nenin 5 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e bazuar.

Nga aktvendimi i shkallës së parë del se, sa i përket veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i mituri Z. B. dhe i mituri A. B., “më datën 02.07.2014., në orët e mbrëmjes, në Prizren, në rrugën, në objektin e rrënuar të spitalit të vjetër infektiv, kanë keqtrajtuar seksualisht të dëmtuarën, në mënyrë që pasi e vërejnë të njëjtën në objektin në fjalë, duke shfrytëzuar moshën e saj dhe gjendjen e dobët fizike, i afrohen dhe kërkojnë që të kenë marrëdhënie seksuale me te, dhe në reagim kundërshtues të dëmtuarës, i mituri A. B. e godet me shuplakë në fytyrë, me ç`rast i shkakton disa shenja, të cilat më afër janë përshkruar në raportin mjekësor të Qendrës emergjente të spitalit rajonal në Prizren me numër të protokollit të datës 02.07.2014. e pastaj, derisa i mituri Z. ia mbanë duart, i mituri A. e kryen aktin seksual me te, në zgavrën anale.” Në arsyet e aktvendimit po ashtu ceket se e dëmtuara quhet S. K., se është e lindur më 08.06.2000. (andaj, në kohën e kryerjes së veprës penale ka pas 14 vjet e 26 ditë), dhe se ajo ka deklaruar se i mituri Z. B. fillimisht e ka goditur me shuplakë në fytyrë dhe e ka mbajtur (ia ka mbajtur duart), ndërsa i mituri A. B. e ka kryer aktin seksual nga mbrapa.

Secili prej të miturve është gjykuar për veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK.

Sipas pretendimeve në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse dispozitivi i aktvendimit të shkallës së parë është i paqartë, e kjo për arsye se është cekur se i mituri Z. B. ia ka mbajtur duart e të dëmtuarës duke mos kryer asnjë veprim tjetër dhe është gjykuar për veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK, andaj, se kjo paraqet një paqartësi sepse vetëm mbajtja e duarve e të dëmtuarës nuk paraqet ndonjë veprim inkriminues të veprës në fjalë penale. Për më tepër, pretendohet se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se ndaj të dëmtuarës është ndërmarrë ndonjë veprim që

do të kishte karakterizuar këtë veprë penale, sepse, përkundër shikimit të menjëhershëm të mjekut nuk është gjetur asnjë lëndim në trupin e saj që kishte treguar për ndonjë veprim seksual dhe se aktvendimet e kundërshtuara bazohen vetëm në deklaratën e saj.

Gjykata Supreme konstaton se nuk qëndron pretendimi se aktvendimet bazohen vetëm në deklaratën e të dëmtuarës, për arsye se prania e të miturve në vendin e ngjarjes është vërtetuar edhe në bazë të mbrojtjeve të tyre dhe nga fakti se janë zënë nga policia në vendin e ngjarjes bashkë me të dëmtuarën, ndërsa e dëmtuara edhe pse për disa detaje ka ndryshuar deklaratën, gjithnjë ka deklaruar se i mituri A.B. e ka kryer aktin seksual “nga mbrapa” përderisa i mituri Z. B. ia ka mbajtur duar. Andaj, aktvendimet e kundërshtuara nuk bazohen vetëm në deklaratën e të dëmtuarës dhe në këtë pikëpamje nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë përkritazi me atë se në regionin peneral dhe anal, të e dëmtuara nuk janë konstatuar lëndime trupore e rrjedhimisht, se nuk është vërtetuar se ndaj saj është kryer akti seksual, kishin të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, ndërsa konform dispozitës së nenit 432.par.2.të KPPK për këtë bazë ligjore nuk mund të ushtrohet ky mjet i jashtëzakonshëm juridik.

Mirëpo, në pjesën tjetër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar.

Në aktvendimin e shkallës së parë, përshkrimi i veprimeve inkriminuese i që të dy të miturve është dhënë në arsyetimin e tij, siç edhe kërkohet me dispozitën e nenit 73.par.3. të KDM. Ky përshkrim faktik është dhënë në faqen 6 në pasusin 3 ku është cekur se që të dy të miturit kanë kryer veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK, duke mos cekur se a e kanë kryer secili veç e veç. Gjykata Supreme konstaton se baza e kësaj veprë penale është vepra penale e dhunimit nga neni 230.të KPPK dhe se kryerja e kësaj veprë penale në bashkëkryerje nuk është e mundur sepse natyra e veprës në fjalë penale është e atillë që paraqet akt individual të një personi, andaj, mund të kryhet nga një person apo nga më shumë persona, por secili prej tyre kryen akt individual dhe veprë të veçantë penale. Në këtë situatë, ka qenë e nevojshme që të precizohet se cilat veprime

konkrete ka ndërmarr secili i mitur, gjegjësisht cilat janë veprimet e të miturit Z. B. të ndërmarra kundër integritetit seksual e të dëmtuarës, e që e karakterizojnë veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK. Në rastin konkret, duke cekur se i mituri Z. B. i ka mbajtur duart e të dëmtuarës (në një vend tjetër ceket se i ka rra me shuplakë në fytyrë dhe ia ka mbajtur duart) e në anën tjetër duke konstatuar se me këtë ka krye veprën në fjalë penale, aktvendimi i shkallës së parë është juridikisht i paqëndrueshëm për shkak të arsyeve të paqarta, e cila e metë nuk është mënjeluar me aktvendimin e shkallës së dytë, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 12.të KPPK.

Për këto arsye, me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë u vendos që aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Në gjykimin e serishëm duhet të mënjanohet shkelja e lartë cekur e dispozitave të procedurës penale, të ceken veprimet konkrete e të miturit Z. B. të cilat janë elemente qenjësore të veprës penale e cila i vihet në barë, për këtë të jepen arsye ligjore dhe merret vendim i ligjshëm.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte paraqitur vetëm për veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235.par.4.pika 6. lidhur me par.1. pika 1. të KPK për të miturin Z. B., u aprovua propozimi që aktvendimet e kundërshtuara të anulohen në tërësi për arsye se në procedurën ndaj të miturit konform dispozitës së nenit 37.par.1.të KDM për veprat penale në bashkim gjykata shqipton vetëm një masë edukuese ose vetëm një dënim. Në gjykimin e serishëm, duhet të merret parasysh se ndaj të miturit Z. B. me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren PM.nr.49/2011 të datës 07.10.2013. është shqiptuar masa edukuese dërgimi në institucionin edukativo korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj për vepra tjera penale, i cili ka filluar të ekzekutohet ashtu që duhet të aplikohet dispozita e nenit 82.të KPK lidhur me nenin 5.dhe 37. Par.2.të KDM.

Nga këto arsye konform nenit 438. par.1.2. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 230/2016, më 12.10.2016.

Proçesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka